

VENDIM


Nr. 38, Datë 13 / 06 / 2007

**PËR DHËNIEN NË HUAPËRDORJE TË OBJEKTIT TË NDODHUR
NË NDËRMARRJEN E SHËRBIMEVE PUBLIKE, SHOQATËS
"ROMANI BAXT ALBANIA" KORÇË.**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Punëve Publike dhe Drejtoria Juridike, bazuar në Ligjin 8652 datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", Neni 32, pika e), si dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për dhënien me Huapërdorje të objektit me sipërfaqe 600 m² të ndodhur në ambjentet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, për zbatimin e projektit "Për menaxhimin e mbetjeve urbane".
2. Afati i dhënies me Huapërdorje të objektit do të jetë i vitit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Punëve Publike.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
RAIMONDA NASE